



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

### V E N D I M

**Nr. 138, Datë 02/08/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 123, datë 07.07.2021, e znj. O.Th., ku pretendohet diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Universitetit të Tiranës, Filiali Sarandë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesja O.Th. është punësuar pranë Universitetit të Tiranës (UT), Filiali Sarandë, në vitin 2007, në pozicionin e Kryetares së Degës Ekonomike. Ankuesja shprehet se ndaj saj nuk është dhënë asnjë masë disiplinore dhe gjithmonë ka qenë korrekte në punën e saj. Nëpërmjet shkresës nr. 23, datë 18.05.2021, të Drejtorit të filialit Sarandë të UT-së, ankuesja është njoftuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, me motivacion ndryshimet në strukturën organizative të këtij filiali. Ajo thekson faktin se nuk ka patur asnjëherë informacion nga ana e Drejtorit të Filialit të UT Sarandë mbi procedurat që janë ndjekur për largimin e saj nga puna.

Në vijim, znj. O.Th. sqaron se pas informacionit të marrë nga Administratori i Universitetit të Tiranës, ajo ka konstatuar se në Buletinin nr. 21, datë 15.02.2021, e Agjensisë së Prokurimit Publik, Filiali Sarandë, i UT kishte publikuar njoftimin për konkurim për pozicionin vakant të “*Kryetares së Degës Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”. Emërtesa e pozicionit të saj të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

punës kishte ndryshuar nga “Kryetare e Degës Ekonomike” në “Kryetare së Degës Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”, si dhe menjëherë ishte shpallur e lirë, për konkurrim.

Ankuesja shprehet se marrëdhëniet e saj të punës me titullarin nuk kanë qenë të mira dhe se ai ka përdorur metoda brutale, kërcënime për largim nga puna, ofendime të rënda dhe pengesë në ushtrimin e detyrave të saj si Kryetare e Degës Ekonomike, duke i mohuar të drejtat e saj ligjore për ushtrimin e kompetencave të pozicionit të saj të punës.

Ankuesja sqaron se është diskriminuar për “çdo shkak tjetër” dhe si të tillë përcakton nepotizmin, pasi ajo pretendon se Drejtori i Filialit Sarandë/UT kërkon të punësojë në pozicionin e saj të punës, znj. S.Th., me të cilën ka lidhje familjare.

#### **A. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri.**

Pas analizimit fillestar, u gjykua që ankesa duhet të plotësohej me informacion të mëtejshëm. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankueses me e-mail, në datën 08.07.2021, ku iu kërkua informacioni i mëposhtëm:

*“1. Të përcaktohet saktësisht shkak i diskriminimit, i cili duhet të jetë i lidhur me karakteristikat tuaja personale. Njëkohësisht, lutemi të sqaroni lidhjen shkakësore ndërmjet këtij shkak dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm, ndaj së cilit pretendoni se jeni ekspozuar nga ana e punëdhënësit tuaj.*

*2. Informacion nëse dhe punonjës të tjerë të institucionit, ku keni punuar, janë larguar në të njëjtën mënyrë, sikurse ju dhe motivacioni i largimit ka qenë i njëjtë.”*

Në përgjigje të e-mailit të KMD-së, ankuesja dërgoi informacionin e datës 09.07.2021, ku sqaron sërish se shkak i diskriminimit është nepotizmi, pasi titullari do të emërojë një person tjetër, me të cilin ka lidhje familjare, në atë pozicionin e punës “Kryetar i Degës Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”. Ndërkohë që, sqaron se askush tjetër nuk është larguar nga puna me motivacionin e saj.

#### **Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ku ndër të tjera përmendet edhe opsioni “për çdo shkak tjetër”. Ky nen përcakton se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me

*HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pikat 1, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e ndryshuar. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Shkak i diskriminimit në vetëvete lidhet me një karakteristikë personale të ankuesit, e cila përbën pikënisje për reagimin e padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë të punëdhënësit ndaj tij. Ankuesja ka vënë në dukje se “nepotizmi” ka qenë shkak i saj i diskriminimit, ndërkohë që ky shkak nuk lidhet me karakteristikat e saj personale dhe nuk përbën shkak të vlefshëm, ligjor, për diskriminimin e pretenduar nga znj. Thomori.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: “*është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa e znj. O.Th. nuk pranohet për shqyrtim, pasi është e pabazuar.

Komisioneri i sugjeron ankueses, që çështjen lidhur largimin e saj nga puna, ta zgjidhë gjyqësisht pranë gjykatës kompetente.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 7, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 123, datë 07.07.2021, e znj. O.Th., pasi është haptazi e pabazuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Punësim  
Shkak – cdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit - mospranim